



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

Data 25.04.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 5 datë 10/04/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Mars 2025"

Analiza ligjore:

Bazuar në ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Ligjin nr. 57/2019, datë 18.7.2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019, "Për Përcaktimin e Procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike", të ndryshuar, Si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 02, datë 27.01.2025, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2025"; Shkresën e Prefekturës së Qarkut Shkodër për shprehje ligjshmërie nr. 106/1 prot, datë 11.02.2025.

Situata aktuale e funksionit: --

Situata financiare : Projekt vendimi propozon që 1-Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Mars 2025 , familje 134, me 450,262 lekë, me 5.98% e fondit total. 2-Në total për Bashkinë Vau Dejës, për Muajin Mars 2025 janë shpallur fitues, 986 familje, me fond 7,574,212 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 454,452 lekë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Sektori i Fuqizimit Ekonomik, Drejtoria e Ndihmës Ekonomike, Arsimit, Turizmit, Rinisë dhe Sportit Sektori i Ndihmes Ekonomike dhe Pak kane relatuar për projekt vendimin.

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Impakti social / grupet që preken: Ky projekt mbetet një mundësi e shkëlqyer për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe familjeve të tyre, si dhe në forcimin e rrjetit të mbështetjes sociale që është kaq i nevojshëm për komunitetin.

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt i konsultimit publik

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut, i mbledhur me datën 25/04/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.5 datë 10/04/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Projekt Vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Mars 2025" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Alcina Livadhi 

(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

Melike Zypce 

(emri, mbiemri, firma)

Zv.Kryetar i komisionit

Sekretar i Komisionit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit
Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare.**

Datë 25/04/2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 1, date 07/04/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me "Për Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.1429 Prot, Datë 26.03.2025, dhe Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.200 Prot, Datë 26.03.2025 "Për Bashkëpunim Ndërvendor në Fushën e Shërbimeve Publike për kryerjen e Investimit "Rikonstruksion i Rrugës së Varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës".

Analiza ligjore

Këshilli i Bashkisë Vau Dejës në zbatim të "Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; Ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 14; neni 31 pika 2; neni 64 pika gj; neni 77 pika m; neni 83 pika 1, të ndryshuar; Ligji Nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025"; VKB Nr.93, datë 21.12.2023 "Për miratimin e projekteve prioritare të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2024"; VKQ Shkodër Nr.19, datë 28.12.2023 "Mbi disa ndryshime mbi prioritetet e Këshillit të Qarkut Shkodër"; VKQ Shkodër nr.26, datë 20.12.2024 "Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA 2025-2027"; VKQ Shkodër Nr.6, datë 13.03.2025 "Mbi disa ndryshime në VKQ nr.26, datë 20.12.2024 "Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA 2025-2027".

Situata aktuale e funksionit:

Ky projekt vendim ka për qëllim miratimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.1429 Prot, datë 26.03.2025, dhe Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.200 Prot, datë 26.03.2025 "Për Bashkëpunim ndërvendor në fushën e Shërbimeve Publike për kryerjen e investimit "Rikonstruksion i Rrugës së Varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës".

Situata financiare :

Miratimi i marreveshjes i hap rruge edhe projekt vendimit te shteses se Buxhetit te Bashkisë miratuar sipas VKB nr 84 datë 23.12.2024 "Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025 2027 numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës", dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025 shtohet me vlerën prej 12,000,000 (dymbëdhjetë milion) lekësh. dhe zerin e investimit "Rikonstruksion i rrugës së Varrezave Melgushe" Bashkia Vau Dejës, ne programin 04520 dhe kod produkti 1570859.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Aseteve Sektori i Asistencës Ligjore Kontratave dhe Çështjeve Gjyqësore ka relatuar përpara komisionit



Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar ose Drejtorinë përgjegjëse për zbatimin e projekteve të caktuara.

Impakti social / grupet që preken: Projekt vendimi impakton jetën banoreve të fshatit Melgushe.

Komisioni i Përhershëm për "Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare", i mbledhur me datën 25/04/2025, shqyrtoi projekt vendimin nr. 1, datë 07/04/2025, relacionin dhe dokumentet shoqëruese "Për Miratimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.1429 Prot, Datë 26.03.2025, dhe Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.200 Prot, Datë 26.03.2025 "Për Bashkëpunim Ndërvendor në Fushën e Shërbimeve Publike për kryerjen e Investimit "Rikonstruksion i Rrugës së Varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës".

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

VENDOSI

T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Neli Copellano Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Arsen Mehmeti Zv. Kryetar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i Komisionit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit
Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare.

Datë 25/04/2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Për shtesën e buxhetit të Bashkisë Vau Dejës, Vkb-në nr 84 datë 23.12.2024", sipas akt marrëveshjes nr.1429 datë 26.03.2025 ndërmjet Këshillit të Qarkut Shkodër dhe Bashkisë Vau Dejës.

Analiza ligjore: Këshilli Bashkiak Vau Dejës, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika" 1.3, nenet 34-37, 40, 41, 54 shkronja "dh" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-30, kreu VI neni 2, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; neni 44 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Ligji 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", VKB nr 84 datë 23.12.2024 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025-2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës", dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025, Udhëzimin Plotësues nr 2 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", Sipas Akt Marrëveshjes nr 1429 date 26.03.2025 "Per Bashkepunim ndervendor ne fushen e Sherbimeve Publike per kryerjen e investimit "Rikonstruksion i rruges së Varrezave Melgushë", Bashkia Vau Dejes, të lidhur mes Këshilli i Qarkut Shkodër përfaqësuar nga Kryetari i Këshillit z.Edmond Ndou dhe Bashkisë Vau Dejës përfaqësuar nga Kryetari z. Kristian Shkreli dhe Vendimit të Qarkut Shkodër nr 6 date 13.03.2025 "Mbi disa Ndryshime ne VKQ nr 26 datë 20.12.2024" Mbi miratimin ne buxhetin e Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA perfundimtar 2025-2027, dhe relacionit të administratës së bashkisë.

Situata aktuale e funksionit: Ky projekt vendim ka për qëllim shtesën e buxhetit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr 84 datë 23.12.2024 'Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025-2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës', dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025. Me zbatimin e buxhetit të vitit 2025 ka lindur nevoja për shtesën e buxhetit të bashkisë për arsye të Akt Marrëveshjes nr 1429 Prot date 26.03.2025 "Për Bashkepunim ndervendor ne fushen e Sherbimeve Publike per kryerjen e investimit "Rikonstruksion i rruges së Varrezave Melgushë", Bashkia Vau Dejes, të lidhur mes Këshillit Shkodër përfaqësuar nga Kryetari i Këshillit z. Edmond Ndou dhe Bashkisë Vau Dejës përfaqësuar nga Kryetari z Kristian Shkreli, e cila është lidhur për mënyrën e lëvrimit të fondeve në të cilën sipas nenti 3 të akt marrëveshjes "Qarku në një kohë sa



më të parë me fondet e planifikuara të vitit 2025 dhe përkatësisht shuma prej 12,000,000 (dymbëdhjetë milion) lekë e planifikuar nga Transferta e Pakushtëzuar e vitit 2025 dhe nga fondet e trashëguara nga viti 2024, bën menjëherë transferimin e kësaj shume tek Bashkia, për kryerjen e investimit me objekt: "Rikonstruksion i rrugës së Varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës". Qarku ka kryer procedurën e transferimit të fondeve sipas pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.6 datë 13.03.2025.

Ky Projekt Vendim është bazuar dhe në Vendimin e Qarkut Shkodër nr 6 date 13.03.2025 "Mbi disa Ndryshime ne VKQ nr 26 datë 20.12.2024" Mbi miratimin ne buxhetin e Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025 dhe PBA përfundimtar 2025-2027, sipas nenit 2 "Te miratohet transferimi i fondit të planifikuar në buxhetin 2025 për investimin "Rikonstruksion i rrugës së varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës në shumën prej 12,000,000 lekësh, nga Këshilli i Qarkut në Bashkinë Vau Dejës. Ky fond do të përdoret për këtë investim por nga Bashkia Vau Dejës.

Situata financiare :

Buxheti i Bashkisë miratuar sipas VKB nr 84 datë 23.12.2024 "Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës", dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025 shtohet me vlerën prej 12,000,000 (dymbëdhjetë milion) lekësh, dhe zerin e investimit "Rikonstruksion i rrugës së Varrezave Melgushë" Bashkia Vau Dejës, ne programin 04520 dhe kod produkti 1570859.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar ka relatuar përpara komisionit

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar ose Drejtorinë përgjegjëse për zbatimin e projekteve të caktuara.

Impakti social / grupet që preken: Projekt vendimi impakton jetën banoreve te fshatit Melgushe.

Komisioni i Përhershëm për "Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare", i mbledhur me datën 25/04/2025, shqyrtoi projekt vendimin, relacionin dhe dokumentet shoqëruese në lidhje me propozimin "Për shtesën e buxhetit të Bashkisë Vau Dejës, Vkb-në nr 84 datë 23.12.2024", sipas akt marrëveshjes nr.1429 datë 26.03.2025 ndërmjet Këshillit të Qarkut Shkodër dhe Bashkisë Vau Dejës, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash:

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
b) miratimin e projektaktit

Neli Topellani
(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

Arsen Mehmeti
(emri, mbiemri, firma)

Zv.Kryetar i komisionit

Sekretar i Komisionit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

Data 25.04.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 8 datë 17/04/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Për Miratimin e Sistemit të Pikëzimit për Programet e Strehimit Social"

Analiza ligjore:

Në mbështetje të nenit 24, neni 54 gërma "n" e Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore", Ligji nr 22/2018" Për strehimin social" i ndryshuar, neni 15 dhe neni 16, VKM nr 384, datë 12.06.2019" Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore, VKM 362, datë 29.05.2019 për kriteret e dhenies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gezojnë përparsi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet bugjetit të shtetit dhe menyren e llogaritjes së tij: të hartuar nga Komisioni i Strehimit i ngritur me VKB nr.21 datë 26.03.2025.

Situata aktuale e funksionit:

Në nenin 15 të ligjit Nr. 22/2018 për " Strehimin Social", i ndryshuar, përzgjedhja e subjekteve dhe familjeve përfituese bëhet nëpërmjet një Sistemi Pikëzimi i cili miratohet për çdo program nga njësia e vetëqeverisjes vendore bazuar në kriteret e përcaktuar me ligj. Bazuar në nenin 15 të ligjit Nr. 22/2018 i ndryshuar për "Strehimin Social" u diskutua mbi sistemin e pikëzimit i cili do aplikohet në zbatim të programit të strehimit "Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme" si dhe për "Sistemin e pikëzimit për trajtimin sipas programit të subvencionit të qirasë në tregun e lirë" për vitin 2025.

Bazuar në ligjin Nr.22/2018 i ndryshuar "Për Strehimin Social" neni 16 "Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve, "Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme" dhe "Sistemi i pikëzimit për trajtimin sipas programit të subvencionit të qirasë në tregun e lirë". Bazuar gjithashtu në problemet sociale dhe nevojave të shfaqura në territorin e Bashkisë Vau Dejës, Komisioni i Strehimit pranë Bashkisë u dakortësua mbi vendosjen e përparësive në pikëzim të kategorive të vendosura në prioritet sipas ligjit.

Situata financiare: Ky projekt vendim nuk ka buxhet.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Drejtoria e Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social Sektori i Strehimit Social kane relatuar për projekt vendimin.

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e projekt vendimit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.

Impakti social / grupet që preken: Ky projekt hap rruge në përmirësimin e kushteve të jetesës te familjeve që kanë probleme e strehimit.

A është objekt i konsultimit publik: Nuk eshte objekt i konsultimit publik

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut , i mbledhur me datën 25/04/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.8 datë 17/04/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Për Miratimin e Sistemit të Pikëzimit për Programet e Strehimit Social" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Alina Livadhi Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Melike Iseni Zv.Kryetar i komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i Komisionit